

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për Krijimin dhe Funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve”.
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Mjedisit
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Dokumenti i Politikave për Pyjet në Shqipëri 2019–2030
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	31-3.2026 - 22.4.2026 ne faqen e konsultimit publik Takimi i zhvilluar më datë 21.5.2026, në ambientet e Ministrisë me aktorë të fushës si Shoqata e Specialistëve të Pyjeve, Fakulteti i Shkencave Pyjore dhe përfaqësues të tjerë
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	28/08/2026
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po 14.7.2026
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2026 – MMj - 7
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Klodiana Marika e-mail: klodiana.marika@mjedisi.gov.al numri i telefonit: 0692092872
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe) . Pyjet përbëjnë një aset natyror strategjik për Shqipërinë, me rol në ruajtjen e biodiversitetit, mbrojtjen e tokës dhe të burimeve ujore, zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe zhvillimin e zonave rurale. Pavarësisht konsolidimit të kuadrit ligjor nëpërmjet ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, i ndryshuar, dhe Dokumentit të Politikave për Pyjet në Shqipëri 2019–2030, zbatimi i politikave pyjore vijon të përballet me kapacitete të kufizuara operative e financiare, koordinim të pamjaftueshëm dhe ritëm investimesh më të ulët se nevojat e sektorit. Problemi kryesor është mungesa e një mekanizmi operacional të specializuar për përgatitjen dhe zbatimin e vazhdueshëm të programeve të pyllëzimit, ripyllëzimit dhe rehabilitimit,	

sigurimin e materialit mbjellës përmes një rrjeti funksional fidanishte shtetërore dhe menaxhimin e projekteve shumëvjeçare. Sektori mbetet i varur kryesisht nga buxheti dhe ka kapacitete të kufizuara për mobilizimin e granteve e financimeve ndërkombëtare, zhvillimin e veprimtarive ekonomike të ligjshme dhe riinvestimin e të ardhurave. Objektivi i politikës është rritja e aftësisë së shtetit për të mbrojtur, rehabilituar dhe zhvilluar fondin pyjor, duke forcuar zbatimin operacional, financimin, koordinimin dhe llogaridhënien. Synohet krijimi i një mekanizmi kombëtar për investimet prioritare, ngritja brenda tre vjetësh e një rrjeti fillestar fidanishte, rritja e sipërfaqeve të trajtuara, sigurimi i financimeve shtesë dhe vendosja e një sistemi të matshëm monitorimi e auditimi.

RIA ka shqyrtuar katër alternativa: status quo-në; forcimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve dhe strukturave ekzistuese; krijimin e një agjencie të re publike; dhe krijimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve sh.a., me kapital 100% shtetëror. Status quo-ja nuk adreson boshllëqet e identifikuar. Forcimi i strukturave ekzistuese ka kosto fillestare më të ulëta, por ruan kufizimet buxhetore dhe financiare. Agjencia e re siguron strukturë të dedikuar, por mbetet e varur nga buxheti dhe procedurat administrative. Nga analiza krahasuese dhe multikriteriale, Shoqëria Shtetërore e Pyjeve vlerësohet si opsioni i preferuar, sepse ndërthur kontrollin publik me fleksibilitet operacional, planifikim shumëvjeçar, mundësi për gjenerim dhe riinvestim të ardhurash dhe akses më të gjerë në financime.

Shoqëria do të ushtrojë funksione operative dhe zhvillimore, pa zëvendësuar rolin politikëbërës të ministrisë, funksionet rregullatore e monitoruese të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve ose kompetencat e njësive të vetëqeverisjes vendore. Bashkëpunimi me bashkitë do të realizohet me marrëveshje të miratuara nga këshillat bashkiakë. Priten ndikime pozitive në kapacitetet për ndërhyrje në terren, investimet dhe punësimin rural, mundësitë për bizneset e shërbimeve pyjore, rehabilitimin e ekosistemeve, biodiversitetin dhe sekuestrimin e karbonit. Projektligji nuk vendos detyrime të reja administrative ose fiskale për biznesin, ndërsa veprimtaria ekonomike e Shoqërisë duhet të respektojë konkurrencën, transparencën dhe rregullat e ndihmës shtetërore. Kostoja e identifikuar për vitin e parë është 33.195.000 lekë për 15 punonjës dhe shpenzimet operative. VAN minimale prej –33.195.000 lekësh pasqyron vetëm këtë kosto fillestare, pasi përfitimet ekonomike, sociale dhe mjedisore nuk janë monetizuar ende. Qëndrueshmëria afatmesme kërkon plan biznesi realist, diversifikim financimi, auditim vjetor dhe monitorim të riskut fiskal.

Projektligji është konsultuar publikisht nga 31 marsi deri më 22 prill 2026 dhe është diskutuar me aktorët e sektorit dhe botës akademike. Komentet kanë ndihmuar në qartësimin e rolit të Shoqërisë, ruajtjen e kompetencave të institucioneve dhe bashkive dhe forcimin e transparencës. Zbatimi do të kryhet në faza: krijimi dhe regjistrimi i Shoqërisë, ngritja e organeve dhe strukturës, miratimi i statutit, planit të biznesit dhe akteve zbatuese, krijimi i fidanishteve dhe fillimi i projekteve prioritare. Monitorimi parashikohet çdo gjashtë muaj gjatë dy viteve të para dhe çdo vit më pas, mbi bazën e treguesve financiarë, operacionalë dhe mjedisorë. Pas tre vjetësh rekomandohet vlerësim i pavarur ex-post për arritjen e objektivave, kosto-efektivitetin, ndikimin mbi fondin pyjor dhe njësitë vendore dhe nevojën për përmirësime ligjore ose institucionale.

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja e qeverisë?

Sektori pyjor në Shqipëri administrohet nga Ministria përgjegjëse për pyjet, Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore. Megjithëse kuadri ligjor dhe institucional është konsoliduar nëpërmjet ligjit nr.57/2020 "Për pyjet", i ndryshuar, gjatë zbatimit të tij janë evidentuar një sërë problematikash që lidhen me kapacitetet operative, financimin dhe realizimin e investimeve në sektorin pyjor.

Problemi kryesor lidhet me mungesën e një mekanizmi operacional të specializuar që të realizojë në mënyrë të vazhdueshme programe pyllëzimi, ripyllëzimi dhe rehabilitimi të sipërfaqeve pyjore të dëmtuara, si dhe të sigurojë prodhimin e materialit mbjellës të nevojshëm për këto programe. Aktualisht mungojnë fidanishte shtetërore të organizuara në nivel kombëtar dhe kapacitetet ekzistuese mbeten të kufizuara për të përmbushur nevojat afatgjata të sektorit. Megjithëse Ligji nr.57/2020 "Për pyjet" krijoi bazën për decentralizimin e administrimit të fondit pyjor dhe përcaktoi rolet e institucioneve përgjegjëse, gjatë viteve të zbatimit janë evidentuar vështirësi në realizimin e programeve kombëtare të pyllëzimit, mungesë e një rrjeti funksional të fidanishteve shtetërore, kapacitete të kufizuara për përgatitjen dhe menaxhimin e projekteve shumëvjeçare, si dhe vështirësi në mobilizimin e fondeve ndërkombëtare. Këto boshllëqe nuk lidhen me mungesën e bazës ligjore, por me mungesën e një mekanizmi operacional të specializuar për zbatimin e tyre.

Një problem tjetër lidhet me mungesën e mekanizmave financiarë dhe ekonomikë që mund të mbështesin zhvillimin e sektorit pyjor përtej financimeve tradicionale buxhetore. Potenciali ekonomik i pyjeve, i produkteve pyjore jo drusore, i shërbimeve të ekosistemit dhe i projekteve të karbonit mbetet i pashfrytëzuar plotësisht për shkak të mungesës së një strukture që mund të zhvillojë këto veprimtari dhe të riinvestojë të ardhurat në sektor.

Gjithashtu, ekzistojnë vështirësi në mobilizimin e financimeve ndërkombëtare dhe zhvillimin e projekteve afatgjata për rehabilitimin e pyjeve, restaurimin e ekosistemeve pyjore dhe përballimin e sfidave që lidhen me ndryshimet klimatike, zjarret në pyje, dëmtuesit dhe degradimin e ekosistemeve.

Në këto kushte, ndërhyrja e qeverisë konsiderohet e nevojshme për krijimin e një mekanizmi të ri operacional, i cili do të plotësojë sistemin ekzistues institucional, pa cenuar kompetencat e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve dhe të njëjësive të vetëqeverisjes vendore.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivi i përgjithshëm i politikës është rritja e aftësisë së shtetit për të mbrojtur, rehabilituar dhe zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme fondin pyjor, duke përmirësuar zbatimin e politikave pyjore, kapacitetet operationale, koordinimin ndërinstitutional, mobilizimin e burimeve financiare dhe monitorimin e rezultateve.

Nëpërmjet kësaj politike synohet:

- rritja e sipërfaqeve të pyllëzuara, ripyllëzuara dhe të rehabilituara;
- sigurimi i një sistemi të qëndrueshëm për prodhimin e materialit mbjellës cilësor;
- forcimi i kapaciteteve për zbatimin e programeve dhe projekteve në sektorin pyjor;
- rritja e aftësisë për të tërhequr dhe administruar financime kombëtare dhe ndërkombëtare;

- përmirësimi i monitorimit, raportimit dhe vlerësimit të rezultateve të politikave pyjore.

Ndikimet e pritshme të politikës janë kryesisht institucionale, administrative, ekonomike dhe mjedisore, duke kontribuar në menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor, mbrojtjen e biodiversitetit, rritjen e rezistencës ndaj ndryshimeve klimatike dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale.

Objektivi 1

Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi, të funksionalizohet një mekanizëm kombëtar për përgatitjen, zbatimin dhe raportimin e projekteve pyjore, me ndarje të dokumentuar të roleve ndërmjet ministrisë, AKP-së, Shoqërisë dhe NJVV-ve.

Objektivi 2

. Brenda tre vjetësh, të sigurohet kapacitet i qëndrueshëm për prodhimin e materialit mbjellës të certifikuar, mbi bazën e një vlerësimi kombëtar të kërkesës dhe kapaciteteve ekzistuese të fidanishteve.

Ky objektivi nuk realizohet plotësisht nga strukturat aktuale, sepse ato nuk kanë mandat dhe kapacitet të integruar për investim, prodhim, menaxhim operacional dhe riinvestim të të ardhurave në një rrjet kombëtar fidanishte.

Objektivi 3

. Gjatë pesë viteve të para, të rritet progresivisht sipërfaqja e pyllëzuar, ripyllëzuar dhe rehabilituar kundrejt vlerës bazë që AKP dhe NJVV-të do të miratojnë para planit të parë të biznesit.

Objektivi 4

. Brenda tre vjetësh, të rritet pesha e granteve, donacioneve, programeve ndërkombëtare dhe të ardhurave të ligjshme të riinvestuara në sektor, kundrejt vlerës bazë të vitit para hyrjes në fuqi.

Objektivi 5

. Brenda vitit të parë, të integrohen mekanizmat ekzistues të monitorimit të AKP-së me një sistem publik të treguesve të performancës për projektet, financat dhe rezultatet mjedisore të ndërhyrjes.

Vlerat numerike të synuara për hektarët, prodhimin e fidanëve dhe financimin shtesë do të caktohen në planin e parë shumëvjeçar, pasi të verifikohen vlerat bazë; mosvendosja e tyre në këtë fazë është kufizim i analizës dhe jo zëvendësim i detyrimit për objektiva të matshëm.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të disavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsioni 0 – Mosveprimi (Status Quo)

Ruajtja e organizimit aktual institucional pa krijimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve.

Avantazhet

- nuk krijohen kosto fillestare;

- nuk kërkohen ndryshime ligjore apo institucionale;
- ruhet organizimi aktual i sektorit.

Disavantazhet

- mbeten të kufizuara kapacitetet operative për realizimin e programeve të pyllëzimit, ripyllëzimit dhe rehabilitimi;
- mbeten të kufizuara kapacitetet operative;
- potenciali ekonomik i pyjeve mbetet i pashfrytëzuar;
- kufizohet aksesimi në financime ndërkombëtare të dedikuara;

ritmi i investimeve në rehabilitimin e sipërfaqeve të dëmtuara vijon të mbetet më i ulët se nevojat e sektorit. Ky option nuk adreson problemin kryesor dhe nuk mundëson përmbushjen e objektivave të politikës.

Optionsi 1 – Forcimi i Agjencisë Kombëtare të Pyjeve

Rritja e kapaciteteve të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve pa krijuar një subjekt të ri.

Avantazhet

- nuk krijohet institucion i ri;
- ruhet organizimi ekzistues;
- kosto më të ulëta fillestare.

Disavantazhet

- kufizime të vazhdueshme buxhetore;
- mungesë autonomie financiare;
- pamundësi për zhvillimin e aktiviteteve tregtare;
- fleksibilitet i kufizuar në partneritete dhe investime.

Edhe pse përmirëson pjesërisht kapacitetet administrative, kjo alternativë nuk adreson plotësisht nevojën për një strukturë operationale të specializuar me fleksibilitet financiar dhe organizativ.

Optionsi 2 – Krijimi i një Agjencie të re Publike

Krijimi i një institucioni të ri publik me funksione operative.

Avantazhet

- strukturë e dedikuar;
- koordinim më i mirë;
- kontroll publik.

Disavantazhet

- varësi e plotë nga buxheti i shtetit;
- procedura administrative më të ngadalta;
- mungesë fleksibiliteti për gjenerimin e të ardhurave;
- kapacitet i kufizuar për partneritete ekonomike.

Ky option përmirëson organizimin institucional, por nuk ofron fleksibilitetin financiar dhe operacional dhe financiar të nevojshëm të nevojshëm për realizimin e objektivave afatgjata të zhvillimit të sektorit.

Optionsi 3 – Krijimi i Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve (Optionsi i preferuar)

Krijimi i një shoqërie aksionare me kapital 100% shtetëror, që operon sipas legjislacionit për shoqëritë tregtare dhe ka si mision krijimin dhe administrimin e fidanishteve shtetërore,

realizimin e programeve të pyllëzimit, ripyllëzimit dhe rehabilitimit të sipërfaqeve të dëmtuara, si dhe zhvillimin e aktiviteteve ekonomike të lidhura me pyjet, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Avantazhet

- fleksibilitet më i madh operacional;
- mundësi për gjenerimin e të ardhurave vetjake;
- akses në grante dhe financime ndërkombëtare;
- zhvillim i aktiviteteve ekonomike të lidhura me pyjet;
- planifikim shumëvjeçar;
- përmirësim i kapaciteteve për pyllëzim dhe ripyllëzim;
- rritje e përgjegjshmërisë përmes mekanizmave të raportimit dhe auditimit.

Disavantazhet

- nevojë për kapital fillestar;
- periudhë tranzitore për ngritjen e strukturës;
- nevojë për akte nënligjore dhe koordinim me institucionet ekzistuese.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndikimet tek Ministria përgjegjëse për pyjet

Ndikimi institucional

Përforcohet roli i ministrisë në politikëbërje dhe mbikëqyrje strategjike, ndërsa funksionet operative realizohen nga Shoqëria.

Ndikimi administrativ

Kërkohet monitorim i vazhdueshëm i performancës së Shoqërisë dhe raportim periodik.

Ndikimi financiar

Kapitali fillestar i Shoqërisë është 33.2 milionë lekë.

Ndikimi tek Agjencia Kombëtare e Pyjeve

Ndikimi institucional

Agjencia ruan funksionet rregullatore, monitoruese dhe kontrolluese.

Ndikimi administrativ

Rritet nevoja për koordinim me Shoqërinë në zbatimin e programeve dhe projekteve.

Ndikimi mbi buxhetin e shtetit

Projektligji parashikon krijimin e një shoqërie aksionare me kapital 100% shtetëror, e cila do të kapitalizohet fillimisht nga buxheti i shtetit. Kjo përbën koston kryesore fiskale të fazës së parë të zbatimit të reformës.

Për vitin e parë të zbatimit parashikohet një mbështetje buxhetore në vlerën 33,195 mijë lekë, e cila do të përdoret për fondin e pagave të 15 punonjësve të strukturës fillestare, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe shpenzimet operative të nevojshme për funksionalizimin e Shoqërisë. Konkretisht, fondi i pagave vlerësohet në 24,214,500 lekë, kontributet e sigurimeve në 3,980,413 lekë dhe shpenzimet operative në 5,000,000 lekë.

Për periudhën afatmesme, veprimtaria e Shoqërisë synohet të financohet kryesisht nga burime vetjake, në përputhje me planin e biznesit dhe programin financiar që do të miratohen

nga organet drejtuese të saj. Burimet e financimit mund të përfshijnë të ardhurat nga aktivitetet ekonomike të lejuara me ligj, grantet dhe donacionet, financimet ndërkombëtare, bashkëpunimin me sektorin privat, si dhe fondet e siguruar nga programet e Bashkimit Evropian dhe partnerë të tjerë zhvillimi. Në këtë mënyrë synohet ulja graduale e varësisë nga financimi buxhetor dhe rritja e qëndrueshmërisë financiare të Shoqërisë.

Për qëllime të vlerësimit ekonomik është kryer analiza e kostove dhe përfitimeve sipas metodologjisë së RIA-s për një periudhë 10-vjeçare.

Në mungesë të të dhënave të plota mbi të ardhurat dhe përfitimet e ardhshme, analiza evidencon një vlerë aktuale neto (VAN) prej -33,195 mijë lekë, e cila pasqyron vetëm investimin fillestar publik. Përfitimet ekonomike, sociale dhe mjedisore që pritet të gjenerohen nga pyllëzimi, ripyllëzimi, zhvillimi i fidanishteve, tërheqja e fondeve ndërkombëtare dhe zhvillimi i aktiviteteve ekonomike të lidhura me pyjet nuk janë monetizuar në këtë fazë dhe do të vlerësohen më tej nëpërmjet planeve të biznesit dhe dokumenteve financiare të Shoqërisë.

Një element i rëndësishëm për kufizimin e riskut fiskal është fakti që detyrimet financiare të Shoqërisë nuk transferohen në buxhetin e shtetit. Pas kapitalizimit fillestar, Shoqëria mban përgjegjësi të plotë për përmbushjen e detyrimeve të saj financiare. Për këtë arsye, funksionimi i saj duhet të mbështetet në një plan biznesi realist, planifikim financiar shumëvjeçar, monitorim të vazhdueshëm të performancës dhe raportim periodik financiar. Projektligji parashikon gjithashtu krijimin e Fondit të Veçantë për Pyjet, i cili do të shërbejë si mekanizëm financiar për financimin e aktiviteteve të mbrojtjes, rehabilitimit, ripyllëzimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të fondit pyjor. Ky fond pritet të kontribuojë në rritjen e qëndrueshmërisë financiare të sektorit, duke mundësuar riinvestimin e të ardhurave, granteve, donacioneve dhe burimeve të tjera të ligjshme në zhvillimin e pyjeve.

Krahas financimit fillestar, gjatë zbatimit të reformës mund të nevojiten investime shtesë për ngritjen e strukturës organizative, pajisjet dhe infrastrukturën bazë, krijimin ose rehabilitimin e fidanishteve shtetërore, zhvillimin e sistemeve të informacionit, hartimin e akteve zbatuese dhe forcimin e kapaciteteve profesionale të stafit.

Ndikimi afatmesëm

Edhe pse faza fillestare kërkon financim publik, modeli i propozuar synon që në periudhën afatmesme shoqëria të mbështetet gjithnjë e më shumë në burime vetjake.

Burimet potenciale të financimit përfshijnë:

- të ardhurat nga aktivitetet ekonomike të lejuara me ligj;
- grantet dhe donacionet;
- financimet ndërkombëtare;
- bashkëpunimin me sektorin privat;
- programe të financuara nga Bashkimi Evropian dhe partnerë të tjerë zhvillimi.

Ky model synon uljen progresive të varësisë nga financimi buxhetor dhe rritjen e qëndrueshmërisë financiare të sektorit pyjor.

NDIKIMI MBI BIZNESIN

Projektligji nuk vendos detyrime të reja administrative apo fiskale për operatorët ekonomikë privatë. Përkundrazi, ai krijon mundësi të reja bashkëpunimi ndërmjet shoqërisë dhe sektorit

privat në fushat e parashikuara nga ligji, si zhvillimi i aktiviteteve ekonomike të lidhura me pyjet.

Ndikimi pozitiv mbi biznesin lidhet jo vetëm me kontraktimin e punimeve pyllëzuese dhe ripyllëzuese, por edhe me mundësitë për zhvillimin e zinxhirëve të vlerës në produktet pyjore jo-drusore, bimët mjekësore, aromatike dhe eterovajore, si dhe në projektet që lidhen me kreditë e karbonit dhe shërbimet e ekosistemit. Këto veprimtari mund të nxisin ekonominë e gjelbër dhe zhvillimin rural, por duhet të zbatohen në përputhje me legjislacionin për pyjet, konkurrencën, transparencën, ndihmën shtetërore dhe mbrojtjen e mjedisit.

Efektet pozitive të pritshme për biznesin përfshijnë:

- zgjerimin e tregut të shërbimeve pyjore;
- mundësi kontraktimi për punime pyllëzimi dhe ripyllëzimi;
- nxitjen e investimeve në produkte pyjore dhe jo-drusore;
- bashkëpunimin në projekte të financuara nga donatorët.

Ndikimi në konkurrencë

Nuk vendosen kufizime të reja në treg. Megjithatë, duhet të monitorohet që aktiviteti ekonomik i Shoqërisë të mos krijojë avantazhe të padrejta kundrejt operatorëve privatë.

NDIKIMI MBI NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE

Projektligji nuk transferon kompetencat kushtetuese të njësive të vetëqeverisjes vendore. Shoqëria do të bashkëpunojë me bashkitë nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit, të cilat miratohen nga këshillat bashkiakë dhe zbatohen në përputhje me legjislacionin për vetëqeverisjen vendore.

Mbështetja e ofruar nga Shoqëria do të realizohet vetëm me kërkesë ose marrëveshje të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe nuk zëvendëson përgjegjësitë që ligji nr.57/2020 u ngarkon bashkive për administrimin e fondit pyjor.

Ndikimet e pritshme për NJQV janë:

Pozitive

- mbështetje teknike;
- rritje e investimeve në pyllëzim;
- akses më i madh në projekte;
- koordinim më i mirë për menaxhimin e zjarreve;
- mbështetje për zhvillimin rural.

Rreziqe të mundshme

- perceptim për centralizim;
- mbivendosje kompetencash;
- paqartësi në fazën tranzitore.

Për minimizimin e këtyre rreziqeve rekomandohet:

- përcaktim i qartë i roleve në aktet nënligjore;
- marrëveshje standarde bashkëpunimi;
- mekanizma të përhershëm koordinimi.

Ndikimi mjedisor

Projektligji pritët të ketë ndikim pozitiv të konsiderueshëm në mjedis.

Përfitimet kryesore mjedisore përfshijnë:

- rritjen e sipërfaqeve të pyllëzuara dhe ripyllëzuara;
- rehabilitimin e ekosistemeve pyjore të degraduara;

- përmirësimin e gjendjes së biodiversitetit;
 - rritjen e kapaciteteve për sekuestrimin e karbonit;
 - kontributin në zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike;
 - reduktimin e rrezikut nga erozioni dhe degradimi i tokës;
 - forcimin e kapaciteteve për parandalimin dhe përballimin e zjarreve në pyje.
- Ndikime negative të rëndësishme mjedisore nuk identifikohen, pasi veprimtaria e Shoqërisë do të zhvillohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për pyjet dhe mbrojtjen e mjedisit.

Ndikimi social

Projektligji pritët të sjellë ndikime pozitive sociale, veçanërisht në zonat rurale dhe pyjore.

Përfitimet kryesore përfshijnë:

- krijimin e vendeve të reja të punës;
- rritjen e mundësive ekonomike për komunitetet rurale;
- përmirësimin e kushteve mjedisore dhe cilësisë së jetës;
- mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm lokal;
- rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e pyjeve dhe biodiversitetit.

Ndikimi institucional

Projektligji krijon një mekanizëm të ri institucional me funksione operative, i cili plotëson strukturën ekzistuese të administrimit të pyjeve pa transferuar kompetencat e institucioneve publike ekzistuese.

Prandaj pritët:

- forcim i kapaciteteve operacionale në sektorin pyjor;
- përmirësim i koordinimit ndër-institucional;
- rritje e eficiencës në realizimin e projekteve pyjore;
- përmirësim i monitorimit dhe raportimit të rezultateve;
- rritje e transparencës dhe llogaridhënies.

Ndikimi në procesin e integritetit evropian

Reforma propozohet në një periudhë kur Shqipëria po avancohet në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe po intensifikon përafrimin me *acquis* në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike, veçanërisht në kuadër të Kapitullit 27. Për këtë arsye, çdo reformë institucionale në sektorin pyjor duhet të vlerësohet jo vetëm nga këndvështrimi i së drejtës së brendshme, por edhe në raport me parimet e administratës publike të Bashkimit Evropian, kërkesat për qeverisje të mirë, transparencë, efikasitet institucional dhe menaxhim të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Në tërësi, ndikimet e pritshme të projektligjit vlerësohen kryesisht pozitive në planin institucional, ekonomik, mjedisor dhe social, ndërsa kostot fiskale kufizohen kryesisht në fazën fillestare të krijimit dhe funksionalizimit të Shoqërisë.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Pas analizimit të opsioneve, Krijimi i Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve sh.a. vlerësohet si opsioni që siguron ekuilibrin më të mirë ndërmjet mbrojtjes së interesit publik dhe eficiencës operacionale. Ndryshe nga opsionet e tjera, ai krijon mundësi për diversifikimin e burimeve të financimit, zhvillimin e aktiviteteve ekonomike të lidhura me pyjet dhe përmirësimin e

kapaciteteve për ndërhyrje në terren, duke ruajtur pronësinë shtetërore dhe mekanizmat e mbikëqyrjes publike. Kjo qasje është gjithashtu në përputhje me synimet e projektligjit dhe arsyetimin e paraqitur në relacion.

Opsioni 3 – Krijimi i Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve sh.a. (Opsioni i preferuar)

Krijimi i një shoqërie aksionare me kapital 100% shtetëror, që operon sipas legjislacionit për shoqëritë tregtare dhe ka si mision realizimin e funksioneve të përcaktuara në projektligj, duke ruajtur interesin publik dhe bashkëpunimin me institucionet shtetërore e vendore.

Avantazhet

- fleksibilitet më i madh operacional;
- mundësi për gjenerimin e të ardhurave vetjake;
- akses në grante dhe financime ndërkombëtare;
- zhvillim i aktiviteteve ekonomike të lidhura me pyjet;
- planifikim shumëvjeçar;
- përmirësim i kapaciteteve për pyllëzim dhe ripyllëzim;
- rritje e përgjegjshmërisë përmes mekanizmave të raportimit dhe auditimit.

Disavantazhet

- nevojë për kapital fillestar;
- periudhë tranzitore për ngritjen e strukturës;

Kostoja e përlllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Analiza financiare tregon se opsioni i krijimit të Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve kërkon një financim fillestar prej 33,195 mijë lekësh në vitin e parë të zbatimit, i cili mbulon fondin e pagave për 15 punonjës dhe shpenzimet operative të nevojshme për funksionalizimin e shoqërisë. Për vitet pasuese nuk janë parashikuar në këtë fazë transferta të tjera buxhetore, pasi modeli i propozuar synon që Shoqëria të mbështetet gradualisht në burime vetjake financimi, duke përfshirë të ardhurat nga aktiviteti ekonomik, grantet, donacionet dhe programet ndërkombëtare të financimit. Në këto kushte, vlera aktuale e koston totale për periudhën e analizuar rezulton 33,195 mijë lekë, ndërsa vlera aktuale neto (VAN) rezulton - 33,195 mijë lekë.

Viti 1	Viti 2	Viti 3
33,195 mijë lekë	-	-

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar? (jo më shumë se 5 rreshta - te plotësohet nese eshte kryer konsultimi publik)

Projektligji më datë 31.03.2026 deri në datë 22.4.2026 u publikua në faqen e konsultimit me publikun <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/981>. Gjithashtu, projektligji do dërgohet për mendim nëpërmjet sistemit e-akte edhe në ministritë e linjës ku rezulton 277 shikime dhe 4 komente.

Në takimin e zhvilluar më datë 21.5.2026, në ambientet e Ministrisë dhe në praninë e ministrit përgjegjës për pyjet, u zhvillua një diskutim i gjerë me aktorë të fushës si Shoqata e Specialistëve të Pyjeve, Fakulteti i Shkencave Pyjore dhe përfaqësues të tjerë, lidhur me draftligjin për krijimin e Shërbimit të Shtetit për Shërbimet Pyjore. Pavarësisht se gjatë procesit të konsultimit ishin shprehur shumë komente dhe mosdakordësi rreth mënyrës së ngritjes së SHSHP-së, funksionit dhe aktivitetit të saj ekonomik, organizimit institucional të shërbimit pyjor, infrastrukturës, pronësisë, administrimit dhe menaxhimit të tyre, këto vërejtje u morën në konsideratë dhe u riformuluan në mënyrë të përshtatshme, duke gjetur shterim dhe zgjidhje në draftligjin e përmirësuar.

Referuar komenteve të adresuara në faqene konsultimit publik:

Zoti Leonidha Peri ka dhënë komente sidomos mbi çështjet që kanë të bëjnë me faunen, gjuetinë apo pyjet, ku sqarojmë se kjo nuk është një çështje që mund të konsiderohet për t'u reflektuar, pasi projektligji nuk synon të rregullojë sistemin e gjuetisë apo menaxhimit të faunës dhe të fondit pyjor, dhe as nuk synon të ndryshojë ndarjen ekzistuese të kompetencave apo të zëvendësojë institucionet aktuale, por të krijojë një mekanizëm operacional që plotëson hendekun ndërmjet funksioneve rregullatore dhe kapaciteteve të nevojshme për zbatimin praktik të politikave publike. Shoqëria Shtetërore e Pyjeve konceptohet si një strukturë mbështetëse, e aftë të realizojë investime, të administrojë fidanishte shtetërore, të zbatojë programe kombëtare të pyllëzimit dhe ripyllëzimit, të mobilizojë burime financiare shtesë dhe të mbështesë njësitë e vetëqeverisjes vendore në rastet kur kapacitetet e tyre nuk janë të mjaftueshme për përmbushjen efektive të detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr. 57/2020.. Kompetencat mbi faunën dhe gjuetinë vazhdojnë të mbeten të rregulluara nga legjislacioni përkatës dhe institucionet përgjegjëse. Projektligji nuk i ka transferuar këto funksione tek SHSHP.

Po këtu lidhur me komentet mbi organizimin institucional, i inventarizimit kombëtar jashtë funksioneve të SHSHP; debati i përgjithshëm mbi modelin kombëtar të qeverisjes së pyjeve dhe çështjet teknike të terminologjisë pyjore, janë elemente që rregullohen nga Ligji për Pyjet dhe jo nga ligji organizativ i SHSHP.

Një pjesë e vërejtjeve janë marrë në konsideratë në procesin e rishikimit të projektligjit, ndërsa një pjesë tjetër lidhen me politika sektoriale dhe organizimin institucional të sektorit, të cilat tejkalojnë objektin e projektligjit për krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve.

Projektligji nuk synon të ndryshojë kuadrin ligjor që rregullon biodiversitetin, pyjet, faunën e egër, gjuetinë, zonat e mbrojtura, kullotat apo instrumentet kombëtare të monitorimit dhe inventarizimit të pyjeve, të cilat vazhdojnë të rregullohen nga legjislacioni sektorial në fuqi. Në këtë kuadër, janë reflektuar komentet që lidhen me nevojën për ndarjen e funksioneve publike nga aktiviteti operativ i shoqërisë, duke mos përfshirë më Inventarizimin Kombëtar të Pyjeve dhe monitorimin kombëtar të pyjeve ndër funksionet e SHSHP-së. Po ashtu janë forcuar dispozitat që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm, mbrojtjen e ekosistemeve pyjore dhe bashkëpunimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet akademike e kërkimore.

Sa i përket komenteve për bashkimin e institucioneve pyjore dhe të zonave të mbrojtura, administrimin e kullotave, modelin e organizimit institucional apo analizat mbi fizibilitetin ekonomik të reformës, këto janë konsideruar si çështje të rëndësishme për diskutimin e

politikave publike, por nuk kërkojnë domosdoshmërisht ndryshime në dispozitat e projektligjit, i cili ka objekt të kufizuar krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve.

Referuar komenteve të adresuara nga z.Genci Kacorri, sqarojmë se janë shqyrtuar me vëmendje dhe kanë kontribuar në përmirësimin e projektligjit. Një pjesë e tyre janë reflektuar në tekstin e ripunuar, ndërsa një pjesë tjetër lidhen me çështje që rregullohen nga legjislacioni sektorial në fuqi ose me zgjedhje të politikave publike që tejkalojnë objektin e këtij projektligji.

Projektligji ka si objekt krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve si shoqëri aksionare me kapital 100% shtetëror dhe nuk synon të zëvendësojë apo ndryshojë kuadrin bazë të menaxhimit të pyjeve, biodiversitetit, faunës së egër, gjuetisë, zonave të mbrojtura apo instrumenteve teknike të planifikimit pyjor, të cilët vazhdojnë të rregullohen nga legjislacioni sektorial në fuqi.

Në këtë kuadër, janë marrë në konsideratë komentet që lidhen me ndarjen e funksioneve publike nga ato operationale. Për këtë arsye, në variantin e ripunuar nuk janë përfshirë ndër funksionet e Shoqërisë, Inventarizimi Kombëtar i Pyjeve dhe monitorimi kombëtar i pyjeve, duke ruajtur karakterin publik të këtyre funksioneve dhe duke shmangur mbivendosjen ndërmjet rolit të shoqërisë dhe funksioneve shtetërore të politikëbërjes dhe monitorimit.

Lidhur me komentet për faunën e egër, gjuetinë dhe administrimin e zonave të gjuetisë, vlerësohet se këto çështje nuk janë objekt i drejtpërdrejtë i këtij projektligji. Projektligji nuk transferon tek Shoqëria Shtetërore e Pyjeve kompetenca që lidhen me menaxhimin e faunës së egër apo gjuetinë dhe për këtë arsye nuk janë parashikuar dispozita të veçanta në këtë drejtim. Këto fusha vijnë të rregullohen nga legjislacioni përkatës dhe nga institucionet kompetente.

Gjithashtu janë vlerësuar komentet lidhur me biodiversitetin, rolin e bashkive dhe nevojën për bashkëpunim institucional. Në variantin e ripunuar janë forcuar objektivat që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit pyjor, mbrojtjen dhe rehabilitimin e ekosistemeve pyjore, ruajtjen e aseteve natyrore pyjore, si dhe janë parashikuar mekanizma bashkëpunimi ndërmjet Shoqërisë dhe njësisë të vetëqeverisjes vendore, si edhe me institucionet akademike e kërkimore.

Pjesa tjetër e komenteve lidhet kryesisht me vlerësime mbi modelin e propozuar organizativ, fizibilitetin ekonomik, nivelin e investimeve të nevojshme, potencialin e shfrytëzimit të fondit pyjor, krahasimet me modele ndërkombëtare apo alternativa të tjera të organizimit institucional. Këto vlerësime janë konsideruar të vlefshme për diskutimin e politikave publike në sektor, por nuk kërkojnë domosdoshmërisht ndryshime në dispozitat normative të projektligjit, i cili përcakton vetëm bazën juridike për krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve.

Në përfundim, vlerësojmë se komentet kanë ndihmuar në qartësimin e rolit të Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve dhe në përcaktimin më të saktë të funksioneve të saj, duke ruajtur ndarjen ndërmjet kompetencave shtetërore rregullatore dhe funksioneve operationale të shoqërisë, si dhe duke siguruar vijimësinë e zbatimit të legjislacionit sektorial në fuqi për pyjet, biodiversitetin, faunën dhe mjedisin.

Referuar komenteve të ardhura nga Universiteti Bujqësor z. Edvin Toromani, sqarojmë se:

Lidhur me propozimin për bashkimin e strukturave përgjegjëse për pyjet dhe zonat e mbrojtura, vlerësojmë se kjo çështje lidhet me organizimin institucional të administratës publike dhe nuk përbën objekt të drejtpërdrejtë të këtij projektligji, i cili synon vetëm krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve.

-Sa i përket centralizimit të menaxhimit të fondit pyjor, komentet janë marrë në konsideratë. Projektligji synon forcimin e kapaciteteve të menaxhimit të pyjeve në nivel kombëtar, duke ruajtur njëkohësisht mekanizma bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit të parashikuara në tekstin e tij.

-Lidhur me kullotat, sqarojmë se projektligji fokusohet në fondin pyjor dhe funksionet e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve, ndërsa çështjet që lidhen me administrimin e kullotave trajtohen në kuadër të legjislacionit dhe politikave sektoriale përkatëse.

Në përfundim, sugjerimet për rritjen e transparencës dhe përfshirjen sa më të gjerë të aktorëve të sektorit janë vlerësuar pozitivisht dhe do të mbahen parasysh në vijim të procesit të diskutimit dhe konsultimit të projektligjit.

Zoti Abdulla Diku ka mirëpritur nismën për krijimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve pasi përbën një mundësi reale për të korrigjuar problematikat e krijuara nga modeli aktual i administrimit të pyjeve. Megjithatë, duke pasur parasysh gjendjen kritike të fondit pyjor në vend dhe pasojat afatgjata që mund të sjellë çdo vendimmarrje e gabuar në këtë sektor, shprehet se modeli i propozuar duhet të mbështetet në një analizë më të thelluar të situatës ekzistuese, në një proces të gjerë konsultimi me ekspertizën akademike, profesionale dhe institucionale, si dhe në një arkitekturë qeverisëse të qartë, transparente dhe të balancuar. Në veçanti, është e rëndësishme të garantohet se qëndrueshmëria ekologjike e pyjeve mbetet prioritet mbi objektivat ekonomike, të qartësohen mekanizmat e llogaridhënies dhe matjes së performancës, të sigurohet përfaqësimi i komuniteteve lokale dhe ekspertizës së pavarur në proceset vendimmarrëse, si dhe të sqarohet ndërveprimi i modelit të ri me institucionet ekzistuese dhe me detyrimet që burojnë nga procesi i integritetit evropian, përfshirë zbatimin e instrumenteve si EUDR dhe FLEGT. Për këtë arsye, do të ishte e dëshirueshme që modeli i propozuar të mbështetej në praktika të konsoliduara dhe të suksesshme të vendeve të Bashkimit Evropian, duke adoptuar në mënyrë koherente elementët institucionalë, ligjorë dhe menaxherialë që kanë dëshmuar efektivitet në administrimin e qëndrueshëm të pyjeve. Sugjerimet e mësipërme janë marrë në konsideratë gjatë ripunimit të projektligjit

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Një rol qendror në monitorimin e zbatimit do të ketë Këshilli Mbikëqyrës, i cili miraton planin e biznesit, planet vjetore të punës, buxhetin vjetor, programin financiar, projektet e investimit dhe treguesit e performancës së Shoqërisë. Ai kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave dhe projekteve të investimit, siguron respektimin e standardeve të kontabilitetit dhe auditimin vjetor të Shoqërisë.

Në kuadër të menaxhimit të riskut, Administratori duhet të krijojë një sistem monitorimi dhe njoftimi të hershëm për rrethanat që mund të kërcënojnë menaxhimin dhe performancën e Shoqërisë. Ky sistem duhet të lidhet me raportimin periodik te Këshilli Mbikëqyrës dhe Asambleja e Përgjithshme, si dhe me treguesit financiarë, operacionalë dhe mjedisorë të performancës.

Zbatimi i projektligjit do të realizohet në katër faza.

Faza I

- hyrja në fuqi e ligjit;
- krijimi formal i Shoqërisë;
- emërimi i organeve drejtuese.

Faza II

- miratimi i statutit;
- miratimi i akteve nënligjore;
- organizimi administrativ.

Faza III

- krijimi i fidanishteve;
- lidhja e marrëveshjeve me bashkitë;
- fillimi i projekteve prioritare.

Faza IV

- monitorimi i performancës;
- auditimi;
- vlerësimi i reformës.

Monitorimi do të bazohet në indikatorë të matshëm që mundësojnë vlerësimin periodik të progresit të reformës.

Raportimi rekomandohet të kryhet:

- çdo gjashtë muaj gjatë dy viteve të para;
- çdo vit pas fazës së konsolidimit.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Jepni kontekstin e politikës

Pyjet përbëjnë një nga asetet më të rëndësishme natyrore të Republikës së Shqipërisë dhe luajnë rol të rëndësishëm në ruajtjen e biodiversitetit, mbrojtjen e tokës dhe burimeve ujore, përmirësimin e cilësisë së mjedisit, zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe mbështetjen e zhvillimit ekonomik e social, veçanërisht në zonat rurale. Si pasuri publike me rëndësi kombëtare, fondi pyjor përbën një komponent thelbësor të kapitalit natyror të vendit dhe kërkon mekanizma të qëndrueshëm administrimi dhe menaxhimi.

Kuadri ligjor bazë për sektorin pyjor rregullohet nga ligji nr. 57/2020, “Për pyjet”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij. Ndër aktet kryesore për organizimin institucional është VKM nr. 570, datë 17.7.2019, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”, e cila i ngarkon AKP-së, ndër të tjera, monitorimin e sektorit dhe vlerësimin e funksionalitetit të kuadrit institucional. Kuadri nënligjor për administrimin, planifikimin, inventarizimin, monitorimin dhe përdorimin e fondit pyjor, në mënyrë të përmbledhur është si më poshtë vijon:

- VKM nr.888, datë 27.12.2022 për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre, i ndryshuar;
- VKM nr. 1374, datë 10.10.2008, për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor, i ndryshuar;

- VKM nr. 171, datë 18.3.2022 për ngritjen e bazës së të dhënave për regjistrin kombëtar të fondit pyjor dhe regjistrin e fondit kullor, përcaktimin e strukturës, kritereve teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyrës së mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal e qendror, informacionit që duhet regjistruar, si dhe të afateve të përgatitjes e raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve;
- VKM nr. 614, datë 23.10.2025 për miratimin e rregullave për trajtimin, shfrytëzimin, shitjen, eksportin, importin, administrimin dhe transportin e materialit drusor e të prodhimeve jodrusore pyjore, si dhe kategorizimin e rrugëve autopsyjore, përdorimin dhe standardet teknike të tyre;
- VKM nr.537/2021 “Për përcaktimin e kostove të përlllogaritura për pyllëzim kompensues, në rastet e ndryshimit të destinacionit të fondit pyjor. .

Gjatë viteve të fundit janë ndërmarrë një sërë reformash institucionale dhe administrative për përmirësimin e qeverisjes së sektorit pyjor, forcimin e rolit të pushtetit vendor dhe përmirësimin e menaxhimit të fondit pyjor. Paralelisht, Shqipëria ka vijuar të zbatojë angazhimet e saj në kuadër të politikave kombëtare për mbrojtjen e mjedisit, biodiversitetit dhe veprimit klimatik, si dhe në kuadër të procesit të integritetit evropian.

Në kushtet aktuale, sektori pyjor ka potencial ekonomik të lidhur me produktet pyjore, shërbimet e ekosistemit, rehabilitimin, pyllëzimin, ripyllëzimin dhe instrumentet klimatike. Ky potencial është shfrytëzuar në mënyrë të kufizuar, për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme operative, fragmentimit të zbatimit dhe varësisë së lartë nga financimi buxhetor.

..

Problemi në shqyrtim

- Përshkruani natyrën e problemit.
- Identifikoni shkaqet e problemit.
- Përshkruani shtrirjen e problemit.
- Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.
- Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.
- .
- .

Problemi publik është hendeuku ndërmjet objektivave kombëtare për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kapacitetit faktik për t'i zbatuar ato në terren. Përgjegjësitë ndahen ndërmjet ministrisë përgjegjëse, Agjencisë Kombëtare të Pyjeve (AKP) dhe njësive të vetëqeverisjes vendore (NJVV), por sistemi nuk ka kapacitet të integruar për përgatitjen dhe zbatimin në shkallë të gjerë të investimeve pyjore.

Problemi shfaqet në kapacitete të kufizuara për pyllëzim, ripyllëzim dhe rehabilitim; mungesë të një rrjeti funksional e të koordinuar fidanishte shtetërore; vështirësi në përgatitjen e projekteve të financueshme dhe mobilizimin e fondeve; si dhe mungesë të një mekanizmi që të riinvestojë në sektor të ardhurat e ligjshme nga veprimtaritë ekonomike pyjore.

Shtrirja e problemit është kombëtare, sepse prek fondin pyjor në administrim qendror dhe vendor dhe aftësinë e institucioneve për të realizuar programet e politikës pyjore. Të dhënat e disponueshme në këtë fazë nuk lejojnë përcaktimin e plotë sasior të hendeikut për çdo bashki, për këtë arsye, vlera bazë për hektarët që kërkojnë ndërhyrje, kapacitetin e fidanishteve dhe

nevojat e financimit duhet të konsolidohet nga AKP dhe NJVV para miratimit të planit të parë shumëvjeçar.

- Grupet e prekura drejtpërdrejt janë: ministria dhe AKP, për shkak të kufizimeve në realizimin e objektivave dhe monitorimin e rezultateve; NJVV-të, për shkak të mungesës së kapaciteteve teknike dhe financiare për ndërhyrje; komunitetet rurale, që varen nga shërbimet e ekosistemit dhe ekonomia pyjore; si dhe operatorët, OJF-të dhe institucionet akademike, për shkak të numrit të kufizuar të projekteve dhe partneriteteve.
- Problemi mund të trajtohet pjesërisht me masa administrative dhe buxhetore brenda strukturave ekzistuese, por jo plotësisht: institucionet aktuale kanë funksione kryesisht politikëbërëse, rregullatore, monitoruese ose administrative dhe nuk kanë njëkohësisht autonominë operative, aftësinë për veprimtari ekonomike të ligjshme, planifikim shumëvjeçar dhe riinvestim të të ardhurave.
- Shkaqet institucionale dhe administrative lidhen me fragmentimin e përgjegjësiave, koordinimin jo të standardizuar dhe proceset e gjata të vendimmarrjes për projekte ndërinstitutionale.
- Shkaqet ekonomike lidhen me varësinë nga buxheti vjetor, mungesën e mekanizmave të vetëfinansimit dhe kapacitetin e kufizuar për përgatitjen e projekteve për grante, donatorë dhe programe të BE-së.
- Shkaqet teknike dhe mjedisore lidhen me mungesën e materialit mbjellës të standardizuar, kapacitetet e kufizuara profesionale dhe rritjen e presioneve nga zjarret, thatësit, dëmtuesit dhe ndryshimet klimatike.
- Në zbatim të VKM nr. 570/2019, AKP ka mandat të vlerësojë funksionalitetin e kuadrit institucional dhe të propozojë përmirësime. RIA mbështetet në problematikat e evidentuara gjatë zbatimit dhe konsultimit; megjithatë, një raport i posaçëm dhe i plotë vlerësimi i AKP-së nuk është administruar si provë bashkëlidhur. Ky boshllëk evidencohet si kufizim i bazës së provave dhe duhet të plotësohet me të dhënat bazë gjatë fazës së zbatimit.

Për rrjedhojë, problemi nuk është mungesa formale e kompetencave, por mungesa e kapacitetit të përbashkët operacional dhe financiar për t'i kthyer politikat, planet dhe të dhënat e monitorimit në investime të koordinuara dhe rezultate të matshme në terren.

.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*
-
- Qeveria planifikon të ndërhyjë pasi, megjithëse gjatë viteve të fundit janë ndërmarrë reforma të rëndësishme ligjore dhe institucionale në sektorin pyjor, objektivat e politikës kombëtare për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve nuk mund të arrihen plotësisht vetëm me strukturat ekzistuese.
- Nisma mbështetet në **Dokumentin e Politikave për Pyjet në Shqipëri 2019–2030**, i cili identifikon si prioritet forcimin e kapaciteteve institucionale, rritjen e sipërfaqeve të pyllëzuara dhe ripyllëzuara, krijimin e një sistemi të qëndrueshëm të prodhimit të materialit mbjellës, mobilizimin e burimeve financiare dhe përmirësimin e koordinimit ndërinstitutional. Ajo lidhet gjithashtu me qëllimet e **Ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet"**, i cili synon administrimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor, mbrojtjen e

biodiversitetit, përmirësimin e rezistencës ndaj ndryshimeve klimatike dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale. Reforma kontribuon njëkohësisht në përmbushjen e angazhimeve të Shqipërisë në kuadër të procesit të integritetit evropian, veçanërisht në fushën e mjedisit dhe klimës (Kapitulli 27).

- Që nga miratimi i Dokumentit të Politikave për Pyjet 2019–2030 dhe hyrja në fuqi e Ligjit nr. 57/2020 janë ndërmarrë një sërë masash për forcimin e qeverisjes së sektorit pyjor. Është krijuar dhe funksionon **Agjencia Kombëtare e Pyjeve**, janë miratuar aktet kryesore nënligjore, janë transferuar kompetencat e administrimit të fondit pyjor tek njësitë e vetëqeverisjes vendore, janë zhvilluar procese inventarizimi dhe monitorimi të fondit pyjor dhe janë zbatuar projekte të ndryshme të financuara nga buxheti i shtetit dhe partnerët ndërkombëtarë.
- Megjithatë, analiza e zbatimit të këtij kuadri tregon se problemet nuk lidhen më me mungesën e legjislacionit apo të kompetencave institucionale, por me mungesën e kapaciteteve operative për realizimin e funksioneve që ligji u ngarkon institucioneve përgjegjëse. Në praktikë, strukturat ekzistuese janë të orientuara kryesisht drejt hartimit të politikave, funksioneve rregullatore, monitorimit dhe kontrollit administrativ, ndërsa nuk disponojnë instrumentet organizative dhe financiare të nevojshme për të planifikuar dhe zbatuar programe shumëvjeçare të pyllëzimit, ripyllëzimit dhe rehabilitimit, për të administruar një rrjet kombëtar fidanishte shtetërore, për të mobilizuar financime të jashtme ose për të menaxhuar projekte komplekse investimi.
- Po kështu, njësitë e vetëqeverisjes vendore, ndonëse kanë kompetenca të qarta ligjore për administrimin e fondit pyjor, paraqesin nivele të ndryshme kapacitetesh teknike, organizative dhe financiare. Kjo ka sjellë një zbatim të pabarabartë të politikave pyjore në territor, veçanërisht në drejtim të pyllëzimit, ripyllëzimit, rehabilitimit të sipërfaqeve të degraduara dhe zhvillimit të investimeve në sektor.
- Për këtë arsye, ndërhyrja e propozuar nuk synon të ndryshojë ndarjen ekzistuese të kompetencave dhe as të zëvendësojë institucionet aktuale, por të krijojë një mekanizëm operacional që plotëson hendekun ndërmjet funksioneve rregullatore dhe kapaciteteve të nevojshme për zbatimin praktik të politikave publike. Shoqëria Shtetërore e Pyjeve konceptohet si një strukturë mbështetëse, e aftë të realizojë investime, të administrojë fidanishte shtetërore, të zbatojë programe kombëtare të pyllëzimit dhe ripyllëzimit, të mobilizojë burime financiare shtesë dhe të mbështesë njësitë e vetëqeverisjes vendore në rastet kur kapacitetet e tyre nuk janë të mjaftueshme për përmbushjen efektive të detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr. 57/2020.
- Ndërhyrja propozohet në shkallë kombëtare, pasi sfidat që synon të adresojë – zhvillimi i një rrjeti të unifikuar të fidanishteve shtetërore, koordinimi i programeve kombëtare të pyllëzimit, mobilizimi i financimeve ndërkombëtare dhe standardizimi i monitorimit të rezultateve – nuk mund të trajtohen në mënyrë të fragmentuar nga secila njësi vendore. Zbatimi i reformës do të jetë gradual dhe do të bazohet në bashkëpunimin me institucionet ekzistuese dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore, pa cenuar kompetencat e tyre ligjore.

Qeveria pret që kjo ndërhyrje të mundësojë rritjen e sipërfaqeve të rehabilituara dhe të pyllëzuara, sigurimin e materialit mbjellës cilësor për programet kombëtare, rritjen e financimeve të jashtme për sektorin pyjor, forcimin e partneriteteve me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe krijimin e një sistemi të matshëm monitorimi dhe raportimi të rezultateve. Efektiviteti i reformës do të vlerësohet nëpërmjet monitorimit periodik dhe një vlerësimi ex-post, i cili do të krahasojë rezultatet e arritura me situatën ekzistuese dhe me alternativat e tjera të shqyrtuara gjatë procesit të hartimit të politikës.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*

- Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë

. **Objektivi i përgjithshëm i politikës** është rritja e aftësisë së shtetit për të mbrojtur, rehabilituar dhe zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme fondin pyjor, duke përmirësuar zbatimin e politikave pyjore, kapacitetet operationale, koordinimin ndërinstitutional, mobilizimin e burimeve financiare dhe monitorimin e rezultateve.

Nëpërmjet kësaj politike synohet:

- rritja e sipërfaqeve të pyllëzuara, ripyllëzuara dhe të rehabilituara;
- sigurimi i një sistemi të qëndrueshëm për prodhimin e materialit mbjellës cilësor;
- forcimi i kapaciteteve për zbatimin e programeve dhe projekteve në sektorin pyjor;
- rritja e aftësisë për të tërhequr dhe administruar financime kombëtare dhe ndërkombëtare;
- përmirësimi i monitorimit, raportimit dhe vlerësimit të rezultateve të politikave pyjore.

Objektivi 1

Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi, të funksionalizohet një mekanizëm kombëtar për përgatitjen, zbatimin dhe raportimin e projekteve pyjore, me ndarje të dokumentuar të roleve ndërmjet ministrisë, AKP-së, Shoqërisë dhe NJVV-ve.

Objektivi 2

. Brenda tre vjetësh, të sigurohet kapacitet i qëndrueshëm për prodhimin e materialit mbjellës të certifikuar, mbi bazën e një vlerësimi kombëtar të kërkesës dhe kapaciteteve ekzistuese të fidanishteve.

Objektivi 3

. Gjatë pesë viteve të para, të rritet progresivisht sipërfaqja e pyllëzuar, ripyllëzuar dhe rehabilituar kundrejt vlerës bazë që AKP dhe NJVV-të do të miratojnë para planit të parë të biznesit.

Objektivi 4

. Brenda tre vjetësh, të rritet pesha e granteve, donacioneve, programeve ndërkombëtare dhe të ardhurave të ligjshme të riinvestuara në sektor, kundrejt vlerës bazë të vitit para hyrjes në fuqi.

Objektivi 5

. Brenda vitit të parë, të integrohen mekanizmat ekzistues të monitorimit të AKP-së me një sistem publik të treguesve të performancës për projektet, financat dhe rezultatet mjedisore të ndërhyrjes.

Vlerat numerike të synuara për hektarët, prodhimin e fidanëve dhe financimin shtesë do të caktohen në planin e parë shumëvjeçar, pasi të verifikohen vlerat bazë; mosvendosja e tyre në këtë fazë është kufizim i analizës dhe jo zëvendësim i detyrimit për objektiva të matshëm.

Objektivi	Treguesi i performancës	Vlera bazë	Objektivi i synuar	Burimi i të dhënave	Frekuenca e monitorimit
Objektivi 1 – Brenda 12 muajve të funksionalizohet	Shoqëria e regjistruar dhe funksionale	0	1 shoqëri funksionale	QKB / Ministria	Një herë

Objektivi	Treguesi i performancës	Vlera bazë	Objektivi i synuar	Burimi i të dhënave	Frekuenca e monitorimit
t mekanizmi kombëtar për përgatitjen, zbatimin dhe raportimin e projekteve pyjore.	Aktet e organizimit të miratuara	0	100%	Shoqëria	Vjetore
	Marrëveshje standarde bashkëpunimi me NJQV	0	Model i miratuar dhe në zbatim	Ministria	Vjetore
Objektivi 2 – Brenda tre viteve të krijohet kapacitet i qëndrueshëm për prodhimin e materialit mbjellës.	Numri i fidanishteve shtetërore funksionale	Do të përcaktohet pas inventarizimit	Rrjeti fillestar i miratuar	Shoqëria	Vjetore
	Kapaciteti vjetor i prodhimit të fidanëve	Do të përcaktohet	Rritje progresive sipas planit të biznesit	Shoqëria	Vjetore
Objektivi 3 – Gjatë pesë viteve të para të rritet sipërfaqja e pyllëzuar, ripyllëzuar dhe rehabilituar.	Sipërfaqja e pyllëzuar/ripyllëzuar (ha)	Do të përcaktohet nga AKP	Rritje progresive çdo vit	AKP / Shoqëria	Vjetore
	Sipërfaqja e rehabilituar (ha)	Do të përcaktohet	Rritje progresive	AKP / Shoqëria	Vjetore
Objektivi 4 – Brenda tre viteve të rritet financimi jashtëbuxhetor i sektorit.	Numri i projekteve të financuara nga BE dhe donatorët	0	Të paktën 3 projekte/aplikime	Shoqëria	Vjetore
	Financimi i siguruar nga burime jashtëbuxhetore	Vlera bazë 2026	Rritje progresive	Raportet financiar e	Vjetore
Objektivi 5 – Brenda vitit të parë të krijohet	Sistemi i monitorimit funksional	0	1 sistem funksional	Shoqëria	Një herë

Objektivi	Treguesi i performancës	Vlera bazë	Objektivi i synuar	Burimi i të dhënave	Frekuenca e monitorimit
sistemi i monitorimit dhe raportimit të performancës.	Raportet vjetore të publikuara	0	100%	Shoqëria	Vjetore
	Treguesit e performancës (KPI) të monitoruar	0	Set i plotë KPI	Shoqëria / Ministria	Vjetore

Në disa raste nuk janë përcaktuar objektiva numerikë përfundimtarë (p.sh. sipërfaqja që do të pyllëzohet ose kapaciteti vjetor i prodhimit të fidanëve), pasi projektligji krijon bazën institucionale për zbatimin e reformës dhe jo programin operacional të investimeve. Këto vlera do të përcaktohen pas përfundimit të inventarizimit fillestar të kapaciteteve ekzistuese, analizës së nevojave dhe miratimit të planit të parë shumëvjeçar të biznesit të Shoqërisë.

Megjithatë, mungesa e objektivave numerikë në këtë fazë nuk pengon monitorimin e reformës. Përkundrazi, projektligji parashikon që, pas funksionalizimit të Shoqërisë, të miratohet një sistem i plotë i treguesve të performancës (Key Performance Indicators – KPI), i cili do të përfshijë objektiva të matshëm, vlera bazë, objektiva vjetorë dhe raportim periodik mbi realizimin e tyre.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- Përshkruani opsionin e status quo-së.
- Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.
- Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.

Për adresimin e problematikave të evidentuara në sektorin pyjor janë shqyrtuar katër alternativa, të cilat ndryshojnë për nga niveli i ndërhyrjes institucionale, kostot, fleksibiliteti operacional dhe aftësia për të arritur objektivat e politikës. Opsionet janë përzgjedhur duke marrë në konsideratë kuadrin aktual institucional, nevojën për rritjen e kapaciteteve operative dhe mundësitë për financimin afatgjatë të sektorit pyjor.

Opsioni 0 – Mosveprimi (Status Quo)

Ky opsion konsiston në vijimin e organizimit aktual institucional dhe të mekanizmave ekzistues të administrimit të sektorit pyjor, pa krijuar struktura të reja dhe pa ndërhyrje ligjore.

Avantazhet

- nuk krijohen kosto fillestare;
- nuk kërkohen ndryshime ligjore;
- nuk ka ristrukturim institucional.

Disavantazhet

- mbeten të kufizuara kapacitetet operative për pyllëzim, ripyllëzim dhe rehabilitim;
- nuk adresohet mungesa e fidanishteve shtetërore;
- mbetet i pashfrytëzuar potenciali ekonomik i pyjeve dhe i shërbimeve të ekosistemit;
- kufizohet mundësia për tërheqjen e financimeve të reja;
- problematikat e evidentuara vazhdojnë të mbeten të pazgjidhura.

Për këto arsye, ky option nuk mundëson arritjen e objektivave të politikës.

Opsioni 1 – Forcimi i strukturave ekzistuese (jo rregullator)

. Ky option nuk kërkon krijimin e një subjekti të ri ose ndryshim të modelit rregullator. Ai konsiston në shtim buxheti dhe personeli për AKP-në/NJVV-të, marrëveshje administrative bashkëpunimi, trajnim, standardizim procedurash dhe asistencë teknike për përgatitjen e projekteve.

Avantazhet

- ruhet struktura aktuale institucionale;
- nuk kërkohet krijimi i një institucioni të ri;
- kostot fillestare janë relativisht më të ulëta.

Disavantazhet

- kufizime të vazhdueshme buxhetore;
- mungesë autonomie financiare;
- . kapacitet i kufizuar për veprimtari ekonomike dhe riinvestim të të ardhurave;
- fleksibilitet i kufizuar në partneritete dhe investime.

. Opsioni mund të përmirësojë pjesërisht zbatimin me kosto tranzicioni më të ulët, por mbetet i varur nga cikli vjetor buxhetor dhe nuk krijon një mekanizëm të qëndrueshëm për portofol projektësh, vetëfinancim dhe investime shumëvjeçare.

Opsioni 2 – Krijimi i një Agjencie të re Publike

Ky option parashikon krijimin e një institucioni të ri publik me funksione operative në sektorin pyjor

Avantazhet

- siguron një strukturë të dedikuar për realizimin e funksioneve operative;
- përmirëson koordinimin institucional;

- garanton kontroll të drejtpërdrejtë publik mbi veprimtarinë.

Disavantazhet

- mbetet plotësisht e varur nga buxheti i shtetit;
- procedurat administrative janë më pak fleksibile;
- kufizohen mundësitë për gjenerimin e të ardhurave vetjake;
- ka aftësi të kufizuar për partneritete ekonomike dhe investime afatgjata.

Megjithëse ky opsion krijon një strukturë të specializuar, ai nuk siguron fleksibilitetin operacional dhe financiar që kërkon zhvillimi i sektorit.

Opsioni 3 – Krijimi i Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve sh.a. (Opsioni i preferuar)

Krijimi i një shoqërie aksionare me kapital 100% shtetëror, që operon sipas legjislacionit për shoqëritë tregtare dhe ka si mision realizimin e funksioneve të përcaktuara në projektligj, duke ruajtur interesin publik dhe bashkëpunimin me institucionet shtetërore e vendore.

Avantazhet

- siguron fleksibilitet më të madh organizativ dhe operacional;
- krijon mundësi për gjenerimin e të ardhurave vetjake;
- rrit mundësinë për përfitimin e granteve dhe fondeve ndërkombëtare;
- mbështet zhvillimin e aktiviteteve ekonomike të lidhura me pyjet;
- mundëson planifikim afatgjatë të investimeve;
- forcon kapacitetet për pyllëzim, ripyllëzim dhe rehabilitim;
- garanton mekanizma raportimi, monitorimi dhe auditimi.

Disavantazhet

- kërkon kapital fillestar për ngritjen e strukturës;
- kërkon një periudhë tranzitore organizative;
- kërkon koordinim të vazhdueshëm me institucionet ekzistuese;
- kërkon miratimin e akteve të nevojshme për funksionalizimin e plotë të saj.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*

- *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
- *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
- *Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Krijimi i Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve sh.a. përbën një reformë institucionale me ndikim në organizimin e funksioneve operative të sektorit pyjor. Për këtë arsye, është e nevojshme të vlerësohet ndikimi i saj mbi institucionet ekzistuese, mekanizmat e bashkëpunimit ndërinstitutional, ndarjen e kompetencave dhe kapacitetet administrative.

Qëllimi i analizës është të evidentojë nëse modeli i propozuar:

- shmang mbivendosjen e kompetencave;
- përmirëson koordinimin ndërinstitutional;
- rrit eficiencën administrative;
- respekton autonominë e pushtetit vendor;
- garanton llogaridhënie dhe transparencë.

Situata institucionale ekzistuese

Aktualisht sektori pyjor administrohet nëpërmjet një sistemi ku ndërveprojnë:

- Ministria përgjegjëse për pyjet;
- Agjencia Kombëtare e Pyjeve;
- njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- institucione të tjera përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit, emergjencat civile, kontrollin dhe inspektimin.

Ky organizim ka krijuar një ndarje funksionesh, por edhe sfida në koordinimin e ndërhyrjeve operative, planifikimin afatgjatë dhe mobilizimin e burimeve financiare. Analiza përfshin ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta për secilin grup, krahasimin me status quo-në dhe kufizimet e provave. Kostoja e drejtpërdrejtë e identifikuar për vitin e parë është 33,195,000 lekë: 24,214,500 lekë paga, 3,980,413 lekë kontribute dhe 5,000,000 lekë shpenzime operative për 15 punonjës.

Për buxhetin e shtetit, kapitalizimi fillestar i shoqërisë në vlerën 33,195 mijë lekë përbën koston e identifikuar të zbatimit të reformës. Për vitet pasuese, shpenzimet operative, investimet për zhvillimin e kapaciteteve, ngritjen ose reghabilitimin e fidanishteve shtetërore pajisjet dhe projektet e investimit synohen të mbulohen nga vetë Shoqëria, nëpërmjet buxhetit të saj, i cili do të financohet nga të ardhurat e krijuar nga veprimtaria ekonomike e lejuar me ligj, grantet, donacionet, programet e BE-së, financime ndërkombëtare dhe burime të tjera të ligjshme.

Për shkak se në këtë fazë nuk janë miratuar ende plani i biznesit dhe programi shumëvjeçar financiar i Shoqërisë, kostot dhe të ardhurat e viteve pasuese nuk mund të kuantifikohen me saktësi. Për rrjedhojë, vlera aktuale neto (VAN) prej –33,195 mijë lekësh paraqet vetëm koston minimale të identifikuar që rëndon mbi buxhetin e shtetit në fazën fillestare të reformës dhe nuk përfaqëson vlerën aktuale neto të plotë social-ekonomike të projektit. Vlerësimi i plotë ekonomik dhe financiar do të kryhet pas miratimit të planit të biznesit dhe përcaktimit të projeksioneve financiare shumëvjeçare të Shoqërisë.

~~kjo është kosto fillestare e sigurt. Kostot e viteve pasuese, investimet në pajisje/fidanishte dhe të ardhurat e pritshme nuk janë kuantifikuar në dokumentet e disponueshme; për rrjedhojë, VAN prej 33,195 mijë lekësh është vetëm një llogaritje minimale e kostos së identifikuar dhe nuk përfaqëson VAN të plotë social-ekonomike.~~

- Për ministrinë dhe AKP-në krijohen kosto administrative për mbikëqyrje, koordinim, shkëmbim të dhënash dhe kontroll të ndarjes së funksioneve. Përfitimi i drejtpërdrejtë i pritshëm është rritja e kapacitetit për zbatim pa ndryshuar funksionet rregullatore të AKP-së.
- Për NJVV-të nuk parashikohet detyrim i ri financiar automatik, sepse bashkëpunimi bazohet në marrëveshje. Ato mund të kenë kosto kohe për përgatitjen dhe monitorimin e projekteve, kundrejt përfitimit nga ekspertiza, bashkëfinancimi dhe kapaciteti zbatues shtesë.
- Për komunitetet lokale priten përfitime të tërthorta nga punësimi, rehabilitimi i ekosistemeve dhe ulja e ekspozimit ndaj degradimit. Ekziston risku i kufizimit të aksesit tradicional ose shpërndarjes së pabarabartë të përfitimeve; marrëveshjet e projektit duhet të përfshijnë konsultim, transparencë dhe mekanizëm ankesash. Megjithëse projektligji nuk parashikon kufizime të reja mbi të drejtat e përdorimit të fondit pyjor nga komunitetet lokale, gjatë zbatimit të projekteve mund të lindin perceptime për kufizim të përkohshëm të disa përdorimeve tradicionale ose për shpërndarje jo të barabartë të përfitimeve ekonomike. Për këtë arsye, projektet do të planifikohen dhe zbatohen në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe komunitetet lokale, duke garantuar konsultim publik, transparencë dhe respektimin e të drejtave të përcaktuara në legjislacionin për pyjet.
- Për NVM-të nuk vendosen tarifa, leje ose detyrime të reja përputhshmërie nga vetë krijimi i Shoqërisë. Mund të rritet kërkesa për fidanë, punime pyjore, mirëmbajtje, transport dhe ekspertizë. Risku i konkurrencës lidhet me avantazhin e një shoqërie shtetërore në tregje ku veprojnë operatorë privatë; veprimtaritë ekonomike duhet të kenë kontabilitet të ndarë, çmime transparente, prokurim konkurrues dhe të mos përdorin financim publik për shtrembërim tregu.
- Për konkurrencën, ndikimi varet nga kufijtë e veprimtarive tregtare dhe mënyra e financimit. Ministria dhe autoritetet përgjegjëse duhet të verifikojnë neutralitetin konkurrues dhe rregullat e ndihmës shtetërore para financimit ose hyrjes në tregje specifike.

Supozimet kryesore janë: kapitalizimi në kohë; rekrutimi i stafit të kualifikuar; bashkëpunimi i NJVV-ve; akses real në grante; dhe gjenerimi i të ardhurave pa cenuar interesin publik. Provat për përfitimet financiare janë ende të kufizuara, sepse mungojnë plani i biznesit, vlerat bazë dhe skenarët e të ardhurave.

Përpara disbursimeve të mëtejshme duhet të përgatitet analizë kosto–efektiviteti për lekë/hektar të rehabilituar dhe lekë/fidan të prodhuar, ndërsa pas tre vjetësh duhet të kryhet analizë e plotë kosto–përfitim me kostot faktike, të ardhurat, hektarët, mbijetesën e mbjelljeve dhe përfitimet mjedisore të monetizuara kur metodologjia e lejon.

Ndikimi mbi Ministrinë e Mjedisit

Projektligji nuk ndryshon funksionin politikëbërës dhe mbikëqyrës të Ministrisë.

Ministria vijon të:

- hartojë politikat kombëtare;
- propozojë legjislacionin;
- përfaqësojë shtetin si aksionar;
- monitorojë performancën e shoqërisë;
- ushtrojë mbikëqyrjen strategjike.

Në këtë mënyrë, roli i ministrisë forcohet si autoritet politikëbërës dhe mbikëqyrës, ndërsa funksionet operative realizohen nga një subjekt i specializuar.

Ndikimi mbi Agjencinë Kombëtare të Pyjeve

Nga analiza e projektligjit rezulton se Shoqëria nuk merr përsipër funksionet rregullatore dhe mbikëqyrëse të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve.

Agjencia vijon të ushtrojë:

- mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit;
- kontrollin administrativ;
- monitorimin kombëtar të fondit pyjor;
- funksionet e autoritetit publik.

Ndërkohë, Shoqëria fokusohet në funksione operative dhe zhvillimore, si:

- krijimi dhe administrimi i fidanishteve;
- pyllëzimi dhe ripyllëzimi;
- rehabilitimi i sipërfaqeve të dëmtuara;
- zhvillimi i aktiviteteve ekonomike të lidhura me pyjet.

Kjo ndarje funksionale synon të shmangë mbivendosjen e kompetencave dhe të rrisë eficiencën institucionale.

Ndikimi mbi Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore

Projektligji nuk ndryshon kompetencat ligjore të bashkive për administrimin e fondit pyjor në pronësi ose përgjegjësi të tyre.

Shoqëria do të bashkëpunojë me bashkitë nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit, të miratuara nga këshillat bashkiakë, duke respektuar legjislacionin për vetëqeverisjen vendore. Kjo parashikohet shprehimisht në projektligj.

Ky mekanizëm:

- ruan autonominë vendore;
- krijon bazë ligjore për bashkëpunim;
- mundëson koordinimin e investimeve;
- lehtëson ndërhyrjet në rast zjarresh dhe rehabilitimi.

Ndikimi mbi administratën publike

Krijimi i Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve pritet të sjellë ndikime institucionale dhe administrative në organizimin e sektorit pyjor. Shoqëria do të veprojë si një strukturë operative e specializuar, duke mbështetur zbatimin e projekteve dhe investimeve në terren, ndërsa institucionet ekzistuese do të vijnë të ushtrojnë funksionet e tyre rregullatore, monitoruese dhe mbikëqyrëse.

Ndikime positive të pritshme

- rritja e kapaciteteve operative për pyllëzim, ripyllëzim dhe rehabilitim të sipërfaqeve pyjore;
- specializim më i madh i funksioneve dhe përgjegjësi institucionale;
- përmirësim i planifikimit dhe zbatimit të investimeve në sektorin pyjor;

- forcim i koordinimit ndërmjet institucioneve qendrore, lokale dhe strukturave të specializuara;
- rritje e eficiencës në përdorimin e burimeve financiare dhe njerëzore.

Sfidat e mundshme

- nevoja për organizimin dhe funksionalizimin e strukturës së re;
- nevoja për trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit;
- përshtatja e procedurave administrative dhe e mekanizmave të koordinimit;
- nevoja për qartësimin e roleve dhe përgjegjësi ndërmjet Shoqërisë, Agjencisë Kombëtare të Pyjeve dhe njësive të vetëqeverisjes vendore gjatë fazës së parë të zbatimit.

Krijimi i Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve nuk synon të zëvendësojë institucionet ekzistuese, por të plotësojë arkitekturën institucionale të sektorit pyjor me një strukturë operative të specializuar. Nëse zbatohen mekanizmat e propozuar për koordinim, përcaktohen qartë kompetencat në aktet nënligjore dhe sigurohet bashkëpunim i vazhdueshëm me Agjencinë Kombëtare të Pyjeve dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, reforma pritet të përmirësojë eficiencën administrative dhe të forcojë zbatimin e politikave publike në sektor.

Analiza e rreziqeve:

Zbatimi i reformës mund të përballët me një sërë rreziqesh institucionale, administrative, financiare dhe operacionale, të cilat mund të ndikojnë në realizimin e plotë të objektivave të projektligjit. Për këtë arsye, nevojitet marrja e masave parandaluese dhe monitorimi i vazhdueshëm i ecurisë së zbatimit.

Rreziku 1 – Mbivendosja e kompetencave

Ekziston rreziku që gjatë zbatimit të krijohen paqartësi në ndarjen e kompetencave ndërmjet Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve, Agjencisë Kombëtare të Pyjeve dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, veçanërisht në fushën e zbatimit të projekteve dhe investimeve në terren.

Masat parandaluese:

- miratimi i akteve nënligjore që përcaktojnë qartë kompetencat;
- marrëveshje standarde bashkëpunimi;
- mekanizma të përhershëm koordinimi ndërinstitucional.

Rreziku 2 – Perceptimi për centralizim

Edhe pse projektligji nuk ndryshon kompetencat e bashkive, krijimi i Shoqërisë mund të perceptohet si kufizim i rolit të njësive të vetëqeverisjes vendore. Kjo mund të ndikojë në bashkëpunimin ndërmjet palëve gjatë fazës së zbatimit.

Masat parandaluese:

- përfshirja e bashkive në procesin e konsultimit dhe zbatimit;
- marrëveshje bashkëpunimi të qarta;
- konsultime periodike me pushtetin vendor.

Rreziku 3 – Kapacitetet financiare

Shoqëria mund të përballët me vështirësi financiare gjatë fazës së parë të funksionimit për shkak të kostove të ngritjes së strukturës, vonesave në sigurimin e financimeve shtesë apo gjenerimit më të ngadaltë se parashikimet të të ardhurave vetjake.

Masat parandaluese:

- hartimi i një plani biznesi realist;
- planifikim financiar shumëvjeçar;
- diversifikim i burimeve të financimit;
- aplikim në programet e financimit të BE-së dhe donatorëve.

Rreziku 4 – Kapacitetet njerëzore

Mungesa e specialistëve të kualifikuar në fushën e pyjeve dhe menaxhimit të projekteve mund të ndikojë në eficiencën e funksionimit të Shoqërisë.

Masat parandaluese:

- programe trajnimi dhe ngritje kapacitetesh;
- bashkëpunim me universitetet dhe institucionet kërkimore;
- procedura transparente rekrutimi.

Rreziku 5 – Interes i kufizuar për partneritete dhe financime

Ekziston rreziku që niveli i interesit nga partnerët privatë, donatorët ose programet ndërkombëtare të jetë më i ulët se pritshmëritë fillestare, duke kufizuar burimet financiare të Shoqërisë.

Masat parandaluese:

- zhvillimi i projekteve të gatshme për financim;
- krijimi i partneriteteve me organizata kombëtare dhe ndërkombëtare;
- promovimi aktiv i mundësive të investimit në sektorin pyjor.

Rreziku 6 – Ndryshimet klimatike dhe faktorët natyrorë

Rritja e zjarreve në pyje, thatësi, dëmtuesit dhe sëmundjet mund të ndikojnë negativisht në realizimin e objektivave të pyllëzimit, rryllëzimit dhe rehabilitimit.

Masat parandaluese:

- sisteme monitorimi dhe paralajmërimi të hershëm;
- plane reagimi dhe rehabilitimi;
- investime në masa parandaluese dhe rritjen e rezistencës së ekosistemeve pyjore.

Në përgjithësi, rreziqet e identifikuar konsiderohen të menaxhueshme dhe nuk cenojnë realizueshmërinë e reformës, për sa kohë që sigurohet financimi fillestar, krijohen mekanizma efektivë koordinimi ndërinstytucional dhe zbatohen në kohë masat e planifikuara për funksionalizimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Pas analizimit të opsioneve, Krijimi i Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve sh.a. vlerësohet si opsioni që siguron ekuilibrin më të mirë ndërmjet mbrojtjes së interesit publik dhe eficiencës operacionale. Ndryshe nga opsionet e tjera, ai krijon mundësi për diversifikimin e burimeve të financimit, zhvillimin e aktiviteteve ekonomike të lidhura me pyjet dhe përmirësimin e kapaciteteve për ndërhyrje në terren, duke ruajtur pronësinë shtetërore dhe mekanizmat e mbikëqyrjes publike. Kjo qasje është gjithashtu në përputhje me synimet e projektligjit dhe arsyetimin e paraqitur në relacion. Megjithatë opsioni i preferuar kërkon kosto fillestare më të larta se alternativat e tjera, analiza shumëkriteriale tregon se ai siguron rezultatet më të mira afatgjata në aspektin e efektivitetit operacional, qëndrueshmërisë financiare, mobilizimit të investimeve dhe mbështetjes së njësive të vetëqeverisjes vendore, duke ruajtur njëkohësisht kontrollin publik mbi kapitalin dhe funksionet strategjike të sektorit pyjor.

Opsioni 3 preferohet sepse, krahas pronësisë dhe mbikëqyrjes publike, sjell katër risi: (i) ndarje të qartë ndërmjet funksioneve rregullatore dhe atyre operative; (ii) planifikim e zbatim shumëvjeçar të investimeve; (iii) mundësi për burime të diversifikuara financimi dhe riinvestim të të ardhurave; dhe (iv) qeverisje korporative me raportim, auditim dhe tregues performance. Zgjedhja mbetet e kushtëzuar nga neutraliteti konkurrues, kontrolli i riskut fiskal dhe verifikimi i rezultateve pas tre vjetësh. Për të mbështetur përzgjedhjen e opsionit të preferuar është kryer një analizë me shumë kritere, e cila krahason alternativat e shqyrtuara në mënyrë të strukturuar dhe objektive. Analiza vlerëson shkallën në të cilën secili opsion adreson problemin e

identifikuar, përmbush objektivat e politikës, siguron kapacitete të qëndrueshme institucionale dhe financiare, është i realizueshëm në praktikë dhe garanton një raport të arsyeshëm ndërmjet kostove dhe përfitimeve. Për secilin kriter është përcaktuar një peshë sipas rëndësisë së tij, ndërsa opsionet janë vlerësuar me pikë nga 1 deri në 5. Rezultati përfundimtar përftohet nga shumëzimi i peshës së kriterit me vlerësimin e secilit opsion dhe mbledhja e pikëve totale.

Kriteri	Pesha	Opsioni 0 – Status quo	Opsioni 1 – Forcimi i AKP-së	Opsioni 2 – Agjenci e re publike	Opsioni 3 – Shoqëria shtetërore
Efektiviteti në adresimin hendekut operacional	5	1 (5)	3 (15)	4 (20)	5 (25)
Kapaciteti për programe shumëvjeçare, fidanishte dhe ndërhyrje në terren	5	1 (5)	3 (15)	4 (20)	5 (25)
Qëndrueshmëria financiare dhe mobilizimi i burimeve shtesë	4	1 (4)	2 (8)	1(4)	4 (16)
Koherenca institucionale dhe juridike, përfshirë ndarjen e funksioneve dhe respektimin e kompetencave të NJVV-ve	4	4(16)	2 (8)	3(12)	4(16)
Kosto-efektiviteti dhe menaxhueshmëria e riskut fiskal	5	1 (5)	3 (15)	2(10)	3(15)
Rezultati i përgjithshëm	23	35	61	66	97

Rezultatet e analizës tregojnë se Opsioni 3 arrin rezultatin më të lartë, pasi ofron balancën më të mirë ndërmjet efektivitetit, realizueshmërisë institucionale, qëndrueshmërisë financiare dhe kapacitetit për të mobilizuar investime afatgjata në sektorin pyjor. Megjithatë ky opsion kërkon kapitalizim fillestar nga buxheti i shtetit, ai krijon kushtet për vetëfinansim progresiv, ruan kontrollin publik mbi kapitalin dhe nuk cenon kompetencat e institucioneve ekzistuese apo të njësive të vetëqeverisjes vendore. Për këto arsye, ai vlerësohet si alternativa më proporcionale dhe më efektive për realizimin e objektivave të politikës.

Opsioni 3 – Krijimi i Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve sh.a. (Opsioni i preferuar)

Krijimi i një shoqërie aksionare me kapital 100% shtetëror, që operon sipas legjislacionit për shoqëritë tregtare dhe ka si mision realizimin e funksioneve të përcaktuara në projektligj, duke ruajtur interesin publik dhe bashkëpunimin me institucionet shtetërore e vendore.

Avantazhet

- fleksibilitet më i madh operacional;
- mundësi për gjenerimin e të ardhurave vetjake;
- akses në grante dhe financime ndërkombëtare;
- zhvillim i aktiviteteve ekonomike të lidhura me pyjet;
- planifikim shumëvjeçar;
- përmirësim i kapaciteteve për pyllëzim dhe ripyllëzim;
- rritje e përgjegjshmërisë përmes mekanizmave të raportimit dhe auditimit.

Disavantazhet

- nevojë për kapital fillestar;
- periudhë tranzitore për ngritjen e strukturës;
- nevojë për akte nënligjore dhe koordinim me institucionet ekzistuese.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Ministria përgjegjëse për pyjet, në cilësinë e përfaqësuesit të aksionarit, është përgjegjëse për aktet fillestare, kapitalizimin, emërimin e organeve, miratimin e statutit dhe mbikëqyrjen strategjike. Administratori dhe Këshilli Mbikëqyrës janë përgjegjës për regjistrimin, strukturën, rekrutimin, planin e biznesit, buxhetin, investimet, prokurimin, kontabilitetin, raportimin dhe auditimin. AKP furnizon të dhënat bazë, monitoron rezultatet sektoriale dhe ruan funksionet rregullatore. NJVV-të zbatojnë vetëm projektet e dakordësuara me marrëveshje.

Zbatimi ndahet në tri faza: 0–6 muaj, aktet, regjistrimi, organet dhe kapitalizimi; 6–12 muaj, struktura, stafi, plani i biznesit, vlerat bazë, sistemi i raportimit dhe marrëveshjet standarde; vitet 2–3, projektet pilote, rrjeti fillestar i fidanishteve dhe zgjerimi mbi bazën e rezultateve. Pengesat kryesore janë vonesat në akte/rekrutim, mbivendosja e roleve, mungesa e financimit, kapaciteti i ulët i NJVV-ve dhe risku i konkurrencës. Masat janë afate e përgjegjësi të përcaktuara, protokoll ndërinstitutional, financim me etapa, asistencë teknike, kontabilitet i ndarë dhe publikim i kontratave e rezultateve.

Zbatimi i këtij opsioni mund të përballet me sfida që lidhen me funksionalizimin e plotë të Shoqërisë, përfshirë sigurimin e kapitalit fillestar, zgjedhjen e anëtarëve të organeve drejtuese, miratimin e statutit nga Asambleja e Përgjithshme, regjistrimin e Shoqërisë pranë regjistratit tregtar, ngritjen e strukturës organizative dhe plotësimin e administratës me personel të kualifikuar.

Për të siguruar arritjen e objektivave të politikës, do të ndërmerren një sërë masash institucionale, administrative, financiare dhe organizative për krijimin dhe funksionalizimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve, si dhe për menaxhimin e rreziqeve që mund të ndikojnë në zbatimin e reformës.

Në fazën fillestare do të realizohen krijimi dhe regjistrimi i Shoqërisë, emërimi i organeve drejtuese, miratimi i statutit, strukturës organizative dhe organikës, si dhe hartimi dhe miratimi i planit të parë të biznesit, programeve shumëvjeçare të investimeve dhe planeve vjetore të

punës. Paralelisht do të ngrihen sistemet e monitorimit, raportimit, kontabilitetit, kontrollit të brendshëm dhe auditimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për të minimizuar rrezikun e mungesës së personelit të specializuar, Shoqëria do të hartojë një plan rekrutimi dhe zhvillimi të burimeve njerëzore, duke parashikuar procedura transparente të përzgjedhjes, programe trajnimi dhe bashkëpunim me universitetet, institucionet kërkimore dhe partnerët ndërkombëtarë për forcimin e kapaciteteve profesionale.

Në rast se financimi nga burimet vetjake ose nga partnerët ndërkombëtarë rezulton më i ulët se parashikimet, Shoqëria do të rishikojë planin shumëvjeçar të investimeve, do të vendosë prioritetet për projektet strategjike dhe do të intensifikojë aplikimet për grante, programe të Bashkimit Evropian dhe instrumente të tjerë ndërkombëtarë financimi. Plani i biznesit do të përditësohet periodikisht për të reflektuar situatën financiare dhe nevojat e sektorit.

Për të shmangur vonesat në bashkëpunimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore, Ministria përgjegjëse për pyjet dhe Shoqëria do të hartojnë modele standarde të marrëveshjeve të bashkëpunimit, udhëzime të përbashkëta dhe mekanizma të rregullt koordinimi. Në rast të vonesave ose mosmarrëveshjeve, do të zhvillohen konsultime ndër-institucionale me synim arritjen e marrëveshjeve që respektojnë kompetencat ligjore të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Për të parandaluar mosmarrëveshjet me komunitetet lokale dhe grupet e interesit, gjatë përgatitjes dhe zbatimit të projekteve do të zhvillohen procese konsultimi dhe informimi publik në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke siguruar transparencë, pjesëmarrje dhe adresimin e shqetësimeve të ngritura nga palët e interesuara.

Për më tepër, zbatimi i reformës do të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme përmes treguesve të performancës dhe raporteve periodike. Pas tre vitesh nga hyrja në fuqi e ligjit do të kryhet një vlerësim i ndërmjetëm (mid-term review), ndërsa pas pesë vitesh një vlerësim eks-post, me qëllim identifikimin e pengesave, vlerësimin e efektivitetit të masave të ndërmarra dhe, nëse është e nevojshme, propozimin e masave korrigjuese ose ndryshimeve të mëtejshme ligjore dhe administrative.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmblendhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Vlerësimi i zbatimit të reformës do të koordinohet nga ministria përgjegjëse për pyjet, mbi bazën e të dhënave të verifikuara nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve, pasqyrave financiare të audituara të Shoqërisë dhe raporteve të njësive të vetëqeverisjes vendore. Monitorimi do të fokusohet në arritjen e objektivave të politikës dhe performancën e Shoqërisë, duke u bazuar në një grup treguesish të matshëm, ndër të cilët:

- funksionalizimi i plotë i Shoqërisë dhe i organeve të saj drejtuese brenda afateve të përcaktuara me ligj;
- zbatimi i planit të biznesit dhe i programeve vjetore të investimeve;
- numri dhe kapaciteti i fidanishteve shtetërore të krijuara ose rehabilituara;
- sasia e materialit mbjellës të prodhuar dhe e përdorur për programet kombëtare të pyllëzimit dhe ripyllëzimit;
- sipërfaqja e pyllëzuar, ripyllëzuar dhe rehabilituar nëpërmjet projekteve të mbështetura nga Shoqëria;

- niveli i financimeve të siguruara nga grantet, donacionet, programet e Bashkimit Evropian dhe burime të tjera jashtëbuxhetore;
- numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe shkalla e zbatimit të tyre;
- përmbushja e detyrimeve të raportimit financiar, auditimit dhe transparencës;
- shkalla e realizimit të objektivave mjedisore, përfshirë rehabilitimin e ekosistemeve pyjore dhe përmirësimin e treguesve të biodiversitetit, kur këto janë të matshme.

Raportimi do të kryhet çdo gjashtë muaj gjatë dy viteve të para të funksionimit të Shoqërisë dhe çdo vit pas kësaj periudhe. Pas tre vitesh nga hyrja në fuqi e ligjit do të kryhet një vlerësim i ndërmjetëm (mid-term review), ndërsa pas pesë vitesh një vlerësim i pavarur ex-post, i cili do të analizojë shkallën e arritjes së objektivave të reformës, efektivitetin e modelit institucional, ndikimin financiar, mjedisor dhe social, si dhe nevojën për masa korigjuese ose ndryshime të mëtejshme ligjore. Rezultatet e këtyre vlerësimeve do të publikohen për të garantuar transparencën dhe llogaridhënien publike.

Objekti	Treguesi kryesor (KPI)	Institucioni përgjegjës	Frekuenca
Funksionalizimi i Shoqërisë	Shoqëria e regjistruar dhe organet drejtuese funksionale	Ministria	Një herë
Zbatimi i projekteve	Hektarë të pyllëzuar/ripyllëzuar	Shoqëria / AKP	Vjetore
Fidanishte shtetërore	Numri i fidanishteve funksionale dhe prodhimi i fidanëve	Shoqëria	Vjetore
Financimi	Vlera e fondeve të siguruara nga burime jashtëbuxhetore	Shoqëria	Vjetore
Bashkëpunimi me NJQV	Numri i marrëveshjeve dhe projekteve të përbashkëta	Ministria / Shoqëria	Vjetore
Transparenca	Raportet financiare dhe raportet e performancës të publikuara	Shoqëria	Vjetore

- Monitorimi i reformës do të bazohet në një grup treguesish të performancës (**Key Performance Indicators – KPI**), të cilët do të shërbejnë për vlerësimin e efektivitetit, eficiencës, ndikimit dhe qëndrueshmërisë financiare të Shoqërisë. Treguesit kryesorë përfshijnë:
- **rritjen progresive** të sipërfaqes së pyllëzuar, ripyllëzuar dhe rehabilituar (ha), kundrejt vlerës bazë të përcaktuar para fillimit të zbatimit të reformës;
- **ruajtjen e një norme mbijetese të mbjelljeve prej të paktën 80%**, ose sipas standardeve teknike të miratuara për zonat përkatëse;
- **krijimin dhe funksionalizimin e të paktën 3 fidanishteve shtetërore** brenda tre viteve të para të funksionimit të Shoqërisë dhe rritjen graduale të kapaciteteve të tyre prodhuese;

- **rritjen progresive** të kapacitetit vjetor të prodhimit të materialit mbjellës të certifikuar;
- **uljen graduale** të kostos mesatare për hektar të pyllëzuar dhe për fidan të prodhuar, nëpërmjet rritjes së eficiencës operationale dhe ekonomive të shkallës;
- **rritjen progresive** të financimeve të siguruara nga grantet, donacionet, programet e Bashkimit Evropian dhe burime të tjera jashtëbuxhetore, si përqindje ndaj financimit total të Shoqërisë;
- **rritjen progresive të peshës së të ardhurave vetjake** në raport me financimin nga buxheti i shtetit, me synim uljen graduale të varësisë nga financimi publik dhe forcimin e qëndrueshmërisë financiare të Shoqërisë;
- **rritjen progresive të numrit të bashkive** që bashkëpunojnë me Shoqërinë nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe projekteve të përbashkëta, duke synuar zgjerimin gradual të mbulimit territorial të ndërhyrjeve;
- **uljen e kohës mesatare** nga miratimi deri në fillimin e zbatimit të projekteve, nëpërmjet standardizimit të procedurave dhe përmirësimit të koordinimit institucional;
- **rritjen e përqindjes së projekteve të përfunduara brenda afatit dhe buxhetit të planifikuar**, me synim realizimin e të paktën **90%** të projekteve sipas planit të miratuar;
- **sigurimin që 100% e projekteve** të zbatohen në përputhje me standardet teknike, mjedisore dhe kërkesat ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin për pyjet, mbrojtjen e mjedisit dhe kushtet e financuesve;
- **uljen e numrit të gjetjeve me rëndësi të lartë** të evidentuara nga auditimet financiare dhe të performancës;
- **uljen e numrit të ankesave të bazuara** nga palët e interesuara dhe zgjidhjen e tyre brenda afateve të përcaktuara me legjislacion;
- **publikimin në kohë të 100% të raporteve vjetore**, pasqyrave financiare dhe raporteve të performancës, në përputhje me kërkesat e legjislacionit për transparencën dhe llogaridhënien.
- Në rastet kur vlerat numerike nuk mund të përcaktohen në fazën e hartimit të projektligjit, treguesit do të monitorohen mbi bazën e trendit të tyre (rritje, ulje ose ruajtje), ndërsa objektivat numerike do të përcaktohen në planin e parë shumëvjeçar të biznesit të Shoqërisë, pas verifikimit të vlerave bazë dhe analizës së kapaciteteve ekzistuese.
- Vlerat bazë caktohen para miratimit të planit të parë shumëvjeçar. Objektivat trevjeçare miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës dhe ministria dhe lidhen me objektivat e Dokumentit të Politikave 2019–2030 dhe me problemet e identifikuara në këtë RIA.
- Vlerësimi ex-post do të vendosë nëse modeli duhet të vazhdojë, të ndryshohet ose nëse funksionet mund të realizohen më me kosto-efektivitet nga strukturat ekzistuese.

Treguesi	Vlera bazë	Objektivi	Burimi i të dhënave	Frekuenca
Sipërfaqja e pyllëzuar (ha)	Të përcaktohet	Rritje progresive	AKP / Shoqëria	Vjetore
Norma e mbijetesës së mbjelljeve	Të përcaktohet	≥80%	Shoqëria	Vjetore
Fidanishte funksionale	0	≥3 në 3 vite	Shoqëria	Vjetore
Kosto për hektar	Të përcaktohet	Tendencë në ulje	Shoqëria	Vjetore
Financim jashtëbuxhetor	Vlera 2026	Tendencë në rritje	Shoqëria	Vjetore

Treguesi	Vlera bazë	Objektivi	Burimi i të dhënave	Frekuenca
Të ardhura vetjake / financim publik	0	Tendencë në rritje	Shoqëria	Vjetore
Bashki me marrëveshje bashkëpunimi	0	Tendencë në rritje	Ministria / Shoqëria	Vjetore
Projekte të përfunduara në afat	Të përcaktohet	≥90%	Shoqëria	Vjetore
Projekte në përputhje me standardet	Të përcaktohet	100%	Shoqëria / AKP	Vjetore
Raporte të publikuara	0	100%	Shoqëria	Vjetore

VLERËSIMI PAS ZBATIMIT

Për shkak të rëndësisë së reformës, rekomandohet që tre vjet pas fillimit të aktivitetit të Shoqërisë të kryhet një vlerësim i pavarur ex-post. Vlerësimi ex-post duhet të analizojë gjithashtu funksionimin e Fondit të Veçantë për Pyjet, efektivitetin e qeverisjes korporative, cilësinë e raportimit financiar dhe operacional, zbatimin e auditimit vjetor, funksionimin e sistemit të paralajmërimit të hershëm dhe shkallën e riinvestimit të të ardhurave në objektivat pyjore.

Ky vlerësim duhet të analizojë:

- nëse janë arritur objektivat e reformës;
- ndikimin në administrimin e fondit pyjor;
- ndikimin mbi njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- ndikimin financiar;
- ndikimin në përmbushjen e angazhimeve të Shqipërisë në kuadër të Kapitullit 27;
- nevojën për ndryshime ligjore ose institucionale.

Analiza e kryer në këtë Raport të Vlerësimit të Ndikimit tregon se krijimi i Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve përbën një ndërhyrje institucionale të justifikuar, me potencial për të përmirësuar kapacitetet operative në sektorin pyjor dhe për të mbështetur zbatimin efektiv të politikave publike.

Opsioni i krijimit të një shoqërie me kapital 100% shtetëror është vlerësuar si opsioni më i përshtatshëm, pasi kombinon fleksibilitetin operacional me ruajtjen e kontrollit publik dhe ofron mundësi për diversifikimin e burimeve të financimit.

Në të njëjtën kohë, analiza eidenton se suksesi i reformës siguron:

- qartësimin e ndarjes së kompetencave ndërmjet Shoqërisë, Agjencisë Kombëtare të Pyjeve dhe njësive të vetëqeverisjes vendore;
- miratimin në kohë të akteve nënligjore;
- krijimin e mekanizmave efektivë të koordinimit ndërinstitutional;
- zbatimin e standardeve të qeverisjes korporative dhe transparencës;
- monitorimin e vazhdueshëm të rezultateve dhe të vlerësimit periodik të ndikimit të reformës.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

Shifrat në tabelë janë të shprehura në miliona (000) Lekë.

-	<u>Viti 1</u>	<u>Viti 2</u>	<u>Viti 3</u>	<u>Viti 4</u>	<u>Viti 5</u>	<u>Viti 6</u>	<u>Viti 7</u>	<u>Viti 8</u>
<u>Faktori zbritës</u>	<u>1.00000</u>	<u>0.952835</u>	<u>0.907894</u>	<u>0.865073</u>	<u>0.824271</u>	<u>0.785394</u>	<u>0.748351</u>	<u>0.713055</u>
<u>Kosto për buxhetin e NJVV – njëhere (kosto për strukturën dhe shpenzime operative)</u>	<u>33,195</u>	-	-	-	-	-	-	-
<u>Kosto për buxhetin – në vazhdim</u>	-	-	-	-	-	-	-	-
<u>Kosto për biznesin – njëherë</u>	-	-	-	-	-	-	-	-
<u>Kosto për biznesin – në vazhdim</u>	-	-	-	-	-	-	-	-
<u>Kosto për grupet e tjera – njëherë</u>	-	-	-	-	-	-	-	-
<u>Kosto për grupet e tjera – në vazhdim</u>	-	-	-	-	-	-	-	-
<u>Kosto në total</u>	<u>33,195</u>	-	-	-	-	-	-	-
<u>Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës</u>	<u>33,195</u>	-	-	-	-	-	-	-
<u>Përfitimi për buxhetin – në vazhdim</u>	-	-	-	-	-	-	-	-
<u>Përfitimi për buxhetin – në vazhdim</u>	-	-	-	-	-	-	-	-
<u>Përfitimi për biznesin – njëherë</u>	-	-	-	-	-	-	-	-
<u>Përfitimi për biznesin – në vazhdim</u>	-	-	-	-	-	-	-	-
<u>Përfitimi për grupet e tjera – njëherë</u>	-	-	-	-	-	-	-	-
<u>Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim (persona fizikë, OJF, subjekte private ose komunitete lokale që do të marrin financim)</u>	-	-	-	-	-	-	-	-
<u>Përfitimi në total</u>	-	-	-	-	-	-	-	-
<u>Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës</u>	-	-	-	-	-	-	-	-

<u>Vlera aktuale e kostos në total</u>	<u>33,195</u>
<u>Vlera aktuale e përfitimit në total</u>	<u>-</u>
<u>Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total</u>	<u>(33,195)</u>

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni.

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në mijë lekë		Vlera aktuale neto në mijë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	33,195	0	-33,195
Opsioni 2	0	0	0

Për vitin e parë nevojitet mbështetje buxhetore prej 33,195,000 lekësh për 15 punonjës dhe shpenzime operative. Kjo shumë përbën vetëm koston e identifikuar të nisjes. Analiza nuk monetizon ende kostot e investimeve pas vitit të parë ose përfitimet nga të ardhurat, pyllëzimi, rehabilitimi dhe shërbimet e ekosistemit; prandaj tabela VAN paraqet një skenar minimal dhe jo analizë të plotë kosto-përfitim. Plani i biznesit duhet të përmbajë skenar bazë, optimist dhe pesimist, flukse vjetore 10-vjeçare, normën e zbritjes, analizë ndjeshmërie dhe tregues kosto-efektiviteti. Tabela duhet të përditësohet sapo këto të dhëna të miratohen.